



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria e Arsimit
Nr.07-Zyrtarisht
15.09.2023


Në bazë nenit 67, 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolla, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2015 Normativi Për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit në Deçan, shpall:

K O N K U R S
(Për plotësimin e vendeve të lira të punës)

Institucioni: Komuna e Deçan
Drejtoria: Drejtoria e Arsimit

Titulli i vendit të punës:

1. Mësimdhënësi i/e Gjuhës Angleze në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" në Deçan
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 13 orë);
2. Mësimdhënësi i/e Gjuhës Angleze në SHFMU "Sylejman Vokshi" në Prejlep
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 17 orë);
3. Mësimdhënësi i/e Gjuhës Angleze në SHFMU "Dëshmoret e Kombit" në Strelc i Ulët
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 17 orë);
4. Mësues Klase në SHFMU "Dëshmoret e Vokshit" në Pobergjë
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
5. Mësimdhënësi i/e Fizikës në SHFMU "Rexhep Kadrijaj" në Rastavic (10 orë),
SHFMU "Kuvendi i Verrave të Llukës" në Llukë të Epërme (8 orë),
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 18 orë);
6. Mësimdhënësi i/e Fizikës në SHFMU "Esad Mekuli" në Maznik (8 orë),
SHFMU "Ardhmëria" në Beleg (8 orë), SHFMU "Dëshmoret e Kombit" në Strelc i Ulët (4 orë)
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 20 orë);



7. Mësimdhënës i/e Fizikës në SHFMU “Dëshmoret e Baballoqit” në Baballoq (8 orë)
SHFMU “Drita” në Gramaqel (8 orë)
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 16 orë);
8. Mësimdhënës i/e TIK-ut në Gjinnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 20 orë);
9. Mësimdhënës i/e TIK-ut në Gjinnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan (10 orë),
SHFMU “Drita” në Gramaqel (8 orë)
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 18 orë);
10. Mësimdhënës i/e Psikologjisë në Gjinnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 10 orë);
11. Mësimdhënës i/e Sociologjisë në Gjinnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 10 orë);
12. Mësimdhënës i/e Matematikës në Gjinnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 20 orë);
13. Mësimdhënës i/e TIK-ut në IAAP “Tafil Kasumaj” në Deçan
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 20 orë);
14. Mësimdhënës i/e Matematikës në SHFMU “Faik Konica” në Ratish
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 16 orë);
15. Mësimdhënës i/e Matematikës në SHFMU “Heronjtë e Dukagjinit” në Glllogjan
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 16 orë);
16. Mësimdhënës i/e Matematikës në SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan (12 orë),
SHFMU “Isa Boletini” në Isniq (8 orë)
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 20 orë);
17. Mësimdhënës i/e Artit Figurativ në SHFMU “Lan Selimi” në Lumbardh (7 orë),
SHFMU “Ardhmëria” në Beleg (4 orë), SHFMU “Maxhun Çekaj” në Irzniq (4 orë)
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 15 orë);
18. Mësimdhënës i/e TIK-ut në SHFMU “Esad Mekuli” në Maznik
- Numri i Pozitave: (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të caktuar deri 30.07.2023 (8 orë);
19. Mësimdhënës i/e Gjuhës Gjermane në SHFMU “Sylejman Vokshi” në Prijlep (4 orë); SHFMU
“Dëshmorët e Kombit” në Strelcë e Ulët (4 orë); SHFMU “Maxhun Çekaj” në Irzniq (4 orë)
- Numri i Pozitave: (1)

- Periudha e Kontratës: Me kohë të caktuar deri më 31.07.2023 – (12 orë);
- 20. Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU “Isa Boletini” në Isniq
 - Numri i Pozitave: (2)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
- 21. Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në Deçan
 - Numri i Pozitave: (2)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
- 22. Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan
 - Numri i Pozitave: (2)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).
- 23. Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU “Bajram Curri” në Strelc i Epërm
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë)
- 24. Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU “Ardhmëria” në Beleg
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).
- 25. Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU “Rexhep Kadrijaj” në Rastavic
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
- 26. Asistent/e i/e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU “Kuvendi i Verrave të Llukës” në Llukë të Epërme
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).
- 27. Psikolog i/e shkolle në SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në Deçan dhe shkolla tjera
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).
- 28. Psikolog i/e shkolle në SHFMU “Maxhun Çekaj” në Irzniq dhe shkolla tjera
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
- 29. Psikolog i/e shkolle në SHFMU “Kuvendi i Verrave të Llukës” në Llukë të Epërme dhe shkolla tjera
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
- 30. Psikolog i/e shkolle në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan dhe shkolla tjera
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
- 31. Pedagog i/e shkolle në IAAP “Tafil Kasumaj” në Deçan dhe shkolla tjera
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
- 32. Pedagog i/e shkolle në SHFMU “Isa Boletini” në Isniq dhe shkolla tjera
 - Numri i Pozitave: (1)
 - Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);
- 33. Mësimdhënës i/e Lëndëve të Mjekësisë në (IAAP) “Tafil Kasumaj” Deçan
 - Numri i Pozitave: (2)

- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vende të Lira – 20 orë);
- 34. Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e në SHFMU “Maxhun Çekaj” në Irzniq
- Numri i Pozitave : (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë);

- 35. Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e në SHFMU “Heronjtë e Dukagjinit” në Glllogjan
- Numri i Pozitave : (1)
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).

Lloji i Pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Institucionit

Detyrat Kryesore të mësimitdhënësit/ës:

1. Misioni dhe detyra e mësimitdhënësit është të zhvillojë te nxënësi qëndrim, njohuri, shkathtësi, dije dhe t'i japë informata sa më të sakta dhe korrekte në pikëpamje shkencore, kulturore e morale;
2. Mësimitdhënësi është përgjegjës për edukimin dhe formimin korrekt të nxënësve me normat dhe sjelljet e shëndosha morale;
3. Të realizojë planin dhe programin e paraparë edukativ e arsimor, të respektojë rregullat e disiplinës, orarin e mësimit dhe të kërkojë nga nxënësit të kenë sjellje korrekte;
4. Të vishet në përputhje me kodin etik të veshjes dhe me normat pedagogjike-arsimore të sistemit arsimor të Republikës së Kosovës. Në procesin mësimor mësimitdhënësi ka për detyrë të mbajë uniformën e shkollës që e ka zgjedhur Këshilli Drejtues i Shkollës;
5. Përveç procesit të rregullt mësimor, mësimitdhënësi organizon takime të veçanta me grupe nxënësish ose me paralele të caktuara, për tematika dhe objektiva specifike, që do t'u shërbenin nevojave që kanë nxënësit për mësim plotësues ose për mësim shtesë;
6. Mësimitdhënësi harton planin vjetor dhe mujor, përgatit planin ditor, i cili duhet të jetë analitik, racional dhe të pasqyrojë teknologjitë bashkëkohore të mësimitdhënies, punën në grupe, punën individuale, të mësuarit aktiv e krijues, bën vlerësimin e vazhdueshëm të nxënësve dhe në raste të veçanta përgatit edhe PIA-n;
7. Mësimitdhënësi duhet të jetë udhërrëfyes dhe t'i ndihmojë nxënësit në përdorimin e kompjuterëve, projektorit, veglave muzikore dhe pajisjeve të tjera, të përgatisë orët e mësimit me demonstrime e me mjete konkrete: CD, DVD, tabela, vizatime etj.;
8. Mësimitdhënësi mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e orendive dhe pajisjeve në klasat e mësimit, në laboratorë dhe në kabinete. Në rast të shkatërrimit ose dëmtimit, duhet të raportojë menjëherë te drejtori i shkollës, në të kundërtën do të detyrohet të paguajë vetë dëmin e shkaktuar;
9. Mësimitdhënësi mban përgjegjësi për praninë e nxënësve në mësim, evidentimin e mungesave sipas kërkesave dhe rregullave të caktuara nga MASHT;
10. Mësimitdhënësi vendos a duhet të lejojë nxënësin mos të jetë prezent në orën e mësimit, në rastet që i konsideron të arsyeshme; me këtë rast nxënësi shënohet në rubrikën e mungesave me shënimin “me leje” anash;
11. Mësimitdhënësi nuk ka të drejtë ta largojë nga ora mësimore nxënësin i cili nuk i respekton rregullat e sjelljes në orën e mësimit. Nëse problemi nuk mund të menaxhohet, atëherë ai adresohet te drejtori i shkollës apo te bashkëpunëtorët profesional në shkollë (nëse ka).
12. Në rast të mungesës nga mësimi për arsye të ndryshme, mësimitdhënësi është i obliguar ta njoftojë me kohë drejtorin e shkollës;
13. Mësimitdhënësi në procesin mësimor nuk guxon të shkojë në klasë pa Ditarin personal dhe Librin e klasës;
14. Mësimitdhënësi patjetër merr pjesë në mbledhjen e Këshillit të mësimitdhënësve, të Aktiveve profesionale dhe të Këshillit të klasës;
15. Mësimitdhënësi obligohet të marrë pjesë dhe të organizojë aktivitete edukative me nxënësit;
16. Mësimitdhënësi mban përgjithësi për bazën materiale, didaktike etj, që e ka në ngarkim;

17. Mësimdhënësi duhet detyrimisht t'i kompensojë orët e humbura, pavarësisht nga arsyet e humbjes, të ketë paraqitje të rregullt dhe të jetë korrekt në marrëdhënie me të tjerët;
18. Mësimdhënësi duhet ta zbatojë me përpikëri udhëzimin administrativ të MASHT, që përcakton mënyrën e vlerësimit të nxënësve dhe shkallën e arritshme risë së nxënësve.
19. Mësimdhënësi është i obliguar të paraqitet në shkollë së paku 15 minuta para fillimit të mësimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e psikologut

1. Të vlerësojë dhe të interpretojë çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënësve dhe zhvillimin psikologjik, social dhe emocional të nxënësve;
2. Të ofrojë ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë aktorët në shkollë;
3. Të ofrojë ndihmë në identifikimin e nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe të nxënësve të talentuar;
4. Të zhvillojë intervista me nxënës, mësimdhënësit e prindër, vëzhgime e procedura të ndryshme, me qëllim të vlerësimit objektiv, dhe propozon e zbaton masa për intervenime psiko- edukative individuale dhe në grup;
5. Të mbajë lidhjet me arsimtarët lidhur me nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë ose kanë probleme personale;
6. Të këshillojë nxënësit, të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, për mësim plotësues;
7. Të këshillojë nxënësit për zgjedhjen e profesionit si dhe ata që kanë nevojë për këshilla për të tejkaluar problemet personale;
8. Të përgatitë raporte mujore dhe vjetore për drejtorin e shkollës;
9. Të angazhohet në dy e më shumë shkolla, sipas nevojës (aty ku numri i nxënësve është i vogël);
10. Të angazhohet në komisionet profesionale;
11. Të kryejë edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori dhe ato që janë përcaktuar me akte të tjera normative.

Detyrat dhe përgjegjësitë e pedagogut

1. Të kujdeset për realizimin dhe përparimin e punës edukative-arsimore;
2. Të kontribuojë në tejkalimin e problemeve që shfaqen në shkollë, si tek nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe aktorët e tjerë relevantë;
3. Të ndihmojë në hartimin dhe zbatimin e planit zhvillimor të shkollës;
4. Të koordinojë punën e aktiveve profesionale;
5. Të udhëzojë mësimdhënësit në realizimin e veprimtarisë mësimore për zbatimin e metodologjive bashkëkohore;
6. Të monitorojë (hospitohet) dhe të analizojë procesin mësimor;
7. Të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet mësimdhënëseve;
8. Të ndihmojë nxënësit në njohjen e potencialeve të veta, në socializmin e tyre për tejkalimin e vështirësive në të nxënë;
9. Të përgatitë raporte profesionale mujore dhe vjetore për drejtorin e shkollës;
10. Të angazhohet në dy e më shumë shkolla, sipas nevojës (aty ku numri i nxënësve është i vogël);
11. Të kryejë detyra të tjera, të caktuara nga drejtori dhe ato që janë përcaktuar me akte të tjera normative.

Punët detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit për fëmijë/nxënë me nevoja të veçanta arsimore:

- Ndihmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientimin dhe mobilitetin, pozitën dhe uljen e nxënësve në klasë;
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-s, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;

- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim për pjesëmarrje në lojë, stimulimin e të folurit të gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevoja fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- Respekton rregullat dhe etiken e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve;
- Informacionet në shkollë i trajton plotësisht konfidenciale.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e:

1. Të pastrojnë dhe të mirëmbajnë të gjitha ambientet e shkollës, të mirëmbajnë dhe të pastrojnë oborrin dhe lulishten e shkollës;
 2. Rregullisht të pastrojnë me detergjente tërë objektin e shkollës, përkatësisht xhamat e dritareve, dyert, muret, dyshemetë e klasave, të korridoreve, tualetet, sallën e mësimdhënësve, laboratorët, kabinetet dhe bibliotekën e shkollës;
 3. Mirëmbajtësit e higjienës kanë për detyrë të identifikojnë, të evidentojnë, të llogaritin dhe të planifikojnë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen nga amortizimi ose harxhimi i mjeteve të punës të nevojshme për mbajtjen e higjienës dhe, sipas nevojës, t'ia prezantojnë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo- arsimor.
 4. Punëtorët që përbëjnë personelin teknik në shkollë janë të obliguar të bartin uniformën përkatëse gjatë orarit të punës.
- Personeli shërbyes-teknik ka për detyrë të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë që janë përcaktuar në kontratën e punës, në këtë rregullore dhe detyra tjera që u jep drejtori i shkollës.

Kriteret e kualifikimit për Asistent për fëmijë/nxënës më nevoja të veçanta arsimore:

1. Niveli i 5-të (post-sekondar) i kualifikimit asistent, për fëmijët/nxënës më nevoja të veçanta arsimore

Kushtet dhe Kualifikimi – Mësues Klase:

- Fakultetit i Edukimi – programi fillor;
- Fakulteti i Mësuesisë.

Kushtet dhe Kualifikimi – Mësimdhënës i/e Gjuhës Angleze:

Niveli Master Arsimor (300 ECTS);
Sistemi katërvjeçar;
Baçelor katërvjeçar 240 ECTS.

Kushtet dhe Kualifikimi – Mësimdhënës i/e Gjuhës Gjermane:

Niveli Master Arsimor (300 ECTS);
Sistemi katërvjeçar;
Baçelor katërvjeçar 240 ECTS.

Kushtet dhe Kualifikimi – Mësimdhënës i/e Matematikës:

Niveli Master Arsimor (300 ECTS);
Sistemi katërvjeçar;
Baçelor katërvjeçar 240 ECTS.

Kushtet dhe Kualifikimi – Mësimdhënës i/e Fizikës:

Niveli Master Arsimor (300 ECTS);

Sistemi katërvjeçar;
Baçelor katërvjeçar 240 ECTS.

Kushtet dhe Kualifikimi – Mësimdhënës i/e TIK-ut:

Niveli Master Arsimor (300 ECTS);
Sistemi katërvjeçar;
Baçelor katërvjeçar 240 ECTS.

Kushtet dhe Kualifikimi – Mësimdhënës i/e Artit Figurativ:

Niveli Master Arsimor (300 ECTS);
Sistemi katërvjeçar;
Baçelor katërvjeçar 240 ECTS.

Kushtet dhe Kualifikimi – Mjekësi: Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2015, Normativi Për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional 1.Mjekë i Përgjithshëm, 2.Infermier i Përgjithshëm (master - publik).

Kriteret e kualifikimit për Psikolog i/e shkolle:

Psikolog i shkollës – personi i cili ka përfunduar studimet e nivelit Master në degën e Psikologjisë – drejtimi: Psikologji Shkollore dhe Këshillim, të Fakultetit Filozofik (apo siç është rregulluar më UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional).

Kriteret e kualifikimit për Pedagog i/e shkolle:

Pedagog i shkollës – personi i cili ka përfunduar studimet e nivelit Master në degën e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik përkatësisht Fakultetin e Edukimit, studimet katërvjeçare në Degën e Pedagogjisë, (apo siç është rregulluar më UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional).

Kushtet dhe Kualifikimi – Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e

Shkollimi bazik

Detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësit teknik dhe mbështetës shkollë:

1.Të pastrojnë dhe të mirëmbajnë të gjitha ambientet e shkollës, të mirëmbajnë dhe të pastrojnë oborrin dhe lulishten e shkollës;

1. Rregullisht të pastrojnë me detergjente tërë objektin e shkollës, përkatësisht xhamat e dritareve, dyert, muret, dyshemetë e klasave, të korridoreve, tualetet, sallën e mësimdhënësve, laboratorët, kabinetet dhe bibliotekën e shkollës;

2. Mirëmbajtësit e higjienës kanë për detyrë të identifikojnë, të evidentojnë, të llogaritin dhe të planifikojnë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen nga amortizimi ose harxhimi i mjeteve të punës të nevojshme për mbajtjen e higjienës dhe, sipas nevojës, t'ia prezantojnë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo- arsimor.

4. Punëtorët që përbëjnë personelin teknik në shkollë janë të obliguar të bartin uniformën përkatëse gjatë orarit të punës.

Personeli shërbyes-teknik ka për detyrë të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë që janë përcaktuar në kontratën e punës, më rregullore dhe detyra tjera që u jep drejtori i shkollës.

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta – kopje- shtetësi Kosovare) -
- Diploma e kualifikimit e noterizuar te noteri;
- Trajnime (nëse ka);
- Vërtetimin për përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Certifikata e lindjes;
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.
- Me rastin e pranimit kandidati fitues, është i detyruar ta bjerë në DKA certifikatën shëndetësore të lëshuar nga organet kompetente publike.
-

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.

Afati dhe mënyra e publikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data:

15.09.2023 – 29.09.2023

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet duhet ti shkarkojnë nga portali i komunës, dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Drejtorin për Arsim, (Zyrën nr. 52).

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Mirëpriten aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Për çdo paqartësi aplikuesit i drejtohen DKA-së, zyra nr.52 Kati-III.

Rezultatet shpallen në web faqen e komunës së Deçanit <https://kk.rks-gov.net/decan/category/njoftimetshpalljet/>, e-mail ose sms.

